

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik



Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8 , Kashar, Tirana

Adresa

Tiranë

Albania

4000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

+355692035383

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

hr@infosoftoffice.al

E-mail

ADMINISTRATOR Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2026/08/25

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-96376-08-17-2026

Tipi i procedurës për ankesën
Procedure e Prokurimit Publik

Tipi i ankesës
Dokumenta Tenderi

Lloji i procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë

Procedurë e hapur	☐	Procedurë e hapur e thjeshtuar	☐
Procedurë e kufizuar	☐	Procedurë konkurruese me negociim	☐
Partenritet për inovacion	☐	Dialog konkurrues	☐
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit	☐	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	☐
Shërbim Konsulence	☐		
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	☐		

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Gjirokaster

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1923666.00

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Kancelari

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2026/08/28

Numri i njoftimit

CN/51276/08172026

Kodi CPV

30192124-630192130-1

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/dis operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavallefshmërinë)

- Tjetër ☐

☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet ☐

Përshkruani rrethanat e faktit. ☐

Më datë 18.08.2026, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë, “Procedura e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Kancelari”, me fond limit: 1,745,392 (një milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, me REF-96376-08-17-2026.

I- Në NJOFTIMIN E KONTRATËS nga AK-ja ka përcaktuar:

“...Kohëzgjatja në muaj ??? ose ditë 20 ditë nga lidhja e kontrates”;

Në njoftimin e shkurtër të kontratës gjithashtu është përcaktuar: “...20 ditë nga lidhja e kontrates.”

Në Shtojcën 7 (FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT) ndër të tjera është përcaktuar se, “... Afatet e lëvrimit: 20 ditë nga lidhja e kontrates.”;

II- Në Shtojcën 6 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) të DT-së, nga ana e autoritetit kontraktor nuk rezulton të jenë përcaktuar specifikime teknike për artikujt objekt prokurimi.

“?”

Në Shtojcën 7 (FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT) të DT-së, nga ana e autoritetit kontraktor, është përcaktuar se,

“Sasia e mallit që kërkohet: Bashkangjitur në SPE..”

Në dokumentet e ngarkuara në SPE, të emërtuara “LIBRAT.pdf” dhe “prev_pa_cmime.pdf”, janë përcaktuar artikujt që kërkohen të prokurohen me përshkrimet e dhëna nga AK-ja për këta artikuj, ku përfshihen edhe artikujt si më poshtë vijojnë:

Nr.	Emërtimet	Njesia	Sasia Totale	
9	Bllok stick me ngjitje 7*7 me ngjyra	Copë	254	
18	Dosje kartoni kuti arkive me kapak ose me lidhese	Copë	432	
47	Kartela anëtarësimi	Copë	55	
60	Letër printeri termik	Copë	100	

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, afati i lëvrimit të mallrave dhe specifikimet teknike të një pjesë të artikujve duhet të ndryshohen ose të plotësohen.

Në mbështetje të pikës 1 dhe pikës 8 të nenit 110 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i

ndryshuar, të pikës 1/b) dhe pika 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.” brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i procedurës së prokurimit në SPE, po ju paraqesim ankesën e shoqërisë tonë, me argumentet që do ti paraqesim më poshtë në këtë ankesë.:

Paraprakisht e gjejmë më vend të argumentojmë se, kjo ankesë është e dorëzuar brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i procedurës së prokurimit në SPE, sic përcaktohet në pikën 1 të nenit 110 të LPP-së, ku në mënyrë të qartë përcaktohet se:

“?1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë ?”

Procedura e prokurimit rezulton të jetë publikuar në SPE më datë 18.08.2026. Referuar përcaktimeve ligjore të pikës 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.”, rezulton se, dita e fundit për paraqitjen e ankesave të mundshme në lidhje me dokumentat e tenderit duke filluar llogaritjen nga dita e nesërme e publikimit të dokumentave të tenderit në SPE, pra nga e nesërmja e datës 18.08.2026 është data 25.08.2026, pra afati i fundit për dorëzimin e ankesës është data 25.08.2026.

Së fundmi të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me mënyrën e llogaritjes së afatit të ankesave, e konkretisht në vendimin e tij Nr.104/2026, datë 20.01.2026, Komisioni I prokurimit Publik, në faqet 104, 105 të tij, ka arsyetuar si më poshtë:

“?Së dyti, ndryshe nga sa pretendon ankimesi “ Rej” SHPK se ankesa e operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK me nr. ankimi elektronik A/2025/6077 datë 14.11.2025 dhe me nr. 3276 prot., datë 14.11.2025 është paraqitur jashtë afati, në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit, Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....: “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: ... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ.

Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...”, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, është 10 ditë nga dita e nesërme nga

marrja e njoftimit për këtë vendim DHE NË LLOGARITJEN E AFATEVE PËR PARAQITJEN E ANKESËS SIPAS PËRCAKTIMEVE NË PIKËN 5 TË AKTIT RREGULLATOR TË SIPËRCITUAR NUK DO TË PËRFSHIHET DITA E MARRJES SË NJOFTIMIT. Në këtë kuadër, duke qenë se referuar raportit të auditit njoftimi i pjesëmarrësve mbi vendimin e përzgjedhjes është kryer me datë 04.11.2025, paraqitja e ankesës nga operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK me datë 14.11.2025 ka respektuar kushtet formale për paraqitjen e ankesës lidhur me afatin e ankimit?.” Në lidhje me pretendimet tona për ndryshimin e afatit të lëvrimin të mallit dhe për hartimin e specifikimeve teknike të produkteve objekt prokurimi argumentojmë si më poshtë:

Në pikën 1 të Nenit 21 (Autoriteti ose enti kontraktor) të ligjit 162/2020 ”Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

“...1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

NË KUPTIM TË KËSAJ PIKE, AUTORITETI OSE ENTI KONTRAKTOR KA DETYRIMIN TË MIRËPLANIFIKOJË NË CILËSI DHE NË KOHË FONDET PUBLIKE E NEVOJAT E TIJ DHE TË PROKUROJË E TË ZBATOJË KONTRATËN NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI...”.

Në nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP përcaktohet:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet?

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi OSE ORIGINË APO PRODHIM SPECIFIK, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”?)

I- Në lidhje me kërkesën e AK-së, të përcaktuar njoftimin e kontratës dhe në shtojcën 7(FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT) të DT-së, ku përcaktohet se: “Afatet e lëvrimit: 20 (njëzetë) ditëve nga nënshkrimi I kontratës, kërkojmë, të ndryshohet ky afat e të bëhet të paktën 40(ditë) nga lidhja e kontratës.

Po ju paraqesim argumentat tona për sa kërkojmë:

SË PARI:

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave të publikuara në SPE, nga autoriteti kontraktor nuk është dhënë asnjë lloj argumenti në lidhje me afatin e levrimit të mallit, pra për afatin e kërkuar prej 20 ditëve nga lidhja e kontratës. Nëse, AK-ja do të kishte ndonjë arsye objektive për përcaktimin e këtij afati shumë të shkurtër sigurisht që do të duhej ta kishte argumentuar në procesverbalin e hartimit të dokumentave.

SË DYTË:

Mallrat objekt prokurimi janë të destinuara për 13 institucione ne varesi te Bashkisë Gjirokastrë dhe kjo sigurisht kërkon më shumë kohë në dispozicion se sa në rastin nëse lëvrimi I mallit do të bëhej vetëm për një institucion. Kërkohen gjithsej 143 lloje artikujsh të ndryshëm, pra një numër i madh për sa I përket llojeve të artikujve që kërkohen për tu furnizuar.

Autoriteti kontraktor ka pasqyruar për seicilin nga institucionet në varësi të bashkisë Gjirokastrë, sasitë respective për seicilin prej tyre dhe për më tepër e ka kërkuar që ofertimi të bëhet edhe sipas kodeve buxhetore të seicilit institucion, pra seicili prej këtyre 13 institucioneve të bashkisë, do të bëjë procedurat për marrjen e mallrave në dorëzim për sasitë respective të kërkuara prej tyre dhe kjo sigurisht edhe vetëm për këtë shkak këkron më shumë kohë në dispozicion.Mallrat do të dërgohen në adresat e 13 institucioneve të përfshira në këtë procedurë..

SË TRETI:

Pjesa më e madhe e artikujve objekt prokurimi janë mallra të cilat tyre importohen dhe sigurisht që, duhet mbajtur në konsideratë koha që duhet për t'i porositur dhe sjelle mallin në Shqipëri, pasi pavarësisht marreveshjeve dhe kontratave të shumta që ne kemi me prodhues apo distributorë të mallrave objekt prokurimi, nisur nga larmia dhe specifika produkteve që kërkohen nga AK-të, nuk mund ti kesh gjithmonë të gjitha llojet e kërkuara gjendje në magazina. Afati prej 20 ditë nga lidhja e kontratës është një afat shumë i shkurtër dhe mund të pamundësojë dërgimin e mallit në autoritetin kontraktor.

Pjesa tjetër janë blloqe, libra, regjistra, të cilat duhet të prodhohen posacerisht për këtë procedurë prokurimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK-ja dhe kjo sigurisht që kërkon që këto produkte të porositën dhe të prodhohen posacerisht për këtë procedurë prokurimi dhe për këtë autoritet kontraktor, pra nuk janë produkte standarte që mund ti gesh lehtësisht në treg.

Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një afat minimal të arsyeshëm që i mundëson operatorit ekonomik kohën minimale të nevojshme për të porositur dhe prodhuar mallrat objekt prokurimi, pasi në cdo rast është e nevojshme që OE-ja, pas shpalljes përfundimisht si fitues të ketë një kohë minimale për të porositur tek prodhuesit apo distributorët respektivë, mallrat e kërkuara në këtë procedurë prokurimi. Duhet të mbahet në konsideratë koha e nevojshme për porositjen, transportin e tyre tek ofertuesi fitues si dhe koha që nevojitet për dërgimin e mallit deri tek 13 adresat e përcaktuar për dorëzimin e mallit në Bashkinë Gjirokastrë.

SË TRETË:

Komisioni i Prokurimit Publik, në raste të tjera të ngjashme kur ka shqyrtuar ankesa në të cilat ka pasur pretendime në lidhje me afate levrimi të shkurtra, ka mbajtur gjithmonë qëndrimin se, operatorëve ekonomikë duhet t'u lihen afate levrimi të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi objektin e prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumin dhe përmasat e kontratës objekt ? ankimi.

Konkretisht në Vendimin e KPP-së nr. Nr. 393/2024, datë 23.04.2024 është arsyetuar si më poshtë vijon:

“?III.1.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, rezulton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, që levrimi i mallit do të bëhet brenda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës dhe më pas, në përgjigje të pretendimeve të ankimuesit, ka vendosur zgjatjen e këtij afati me 15 ditë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati i levrimit 15 ditë nga lidhja e kontratës nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumin dhe përmasat e kontratës objekt - ankimi, ndaj afati i levrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë, në mënyrë që ofertuesve t'u lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të levrimit të mallit në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës?”

PËR GJITHË SA MË SIPËR, KËRKOJMË që afati i levrimit të ndryshohet dhe të përcaktohet jo më pak se, 40 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

II- Në lidhje me specifikimet teknike të artikujve të përcaktuara në dokumentet e ngarkuara në SPE, të emërtuara “LIBRAT.pdf” dhe “prev_pa_cmime.pdf, e konkretisht për artikujt si më poshtë:

Nr.	Emërtimet	Njesia	Sasia Totale
9	Blok stick me ngjitje7*7 me ngjyra	Copë	254
18	Dosje kartoni kuti arkive me kapak ose me lidhese	Copë	432
47	Kartela anëtarësimi	Copë	55
60	Letër printeri termik	Copë	100

...”, parashtrojmë pretendimet tona si vijojnë:

Për artikullin me nr.9 (Blok stick me ngjitje7*7 me ngjyra), kërkojmë të përcaktoni përmasat e sakta të këtij blloku, pasi produkti: “Blok stick me ngjitje me permasa 7*7”, nuk ekziston në treg. Ky product mund të gjendet në treg në përmasat: 75x75mm; 76x76mm 76x127mm, etj, por jo në përmasat e kërkuara prej autoritetit kontraktor 70x70 mm.

Për artikullin me nr.18 (Dosje kartoni kuti arkive me kapak ose me lidhese), kërkojmë të përcaktoni

qartë se çfarë modeli dosjeje doni për këtë artikull, nëse duhet të jetë me kapak apo me lidhese. Dosja me kapak ndryshon nga dosja me lidhese. Nuk mund të lihet specifikimi evaziv, pasi së pari krijon paqartësi për operatorët në ofertim dhe së dyti lë hapësirë për mosmareveshje gjatë marjes në dorëzim, ndërmjet komisionit dhe operatorit ekonomik. Lutemi publikoni një foto të dosjes që kërkonti të prokuroni.

Për artikullin me nr.47 (Kartela anëtarësimi), artikull për të cilin përveç këtij përshkrimi nuk ka asnjë specifikim tjetër konkret teknik. Lutemi publikoni modelin e kartelës pasi nuk jemi të qartë se si duhet të jetë ky artikull. Specifikimet teknike duhet të jenë të qarta pasi së pari krijon paqartësi për operatorët në ofertim dhe së dyti lë hapësirë për mosmareveshje gjatë marjes në dorëzim, ndërmjet komisionit dhe operatorit ekonomik. Lutemi publikoni minimalisht një foto të artikullit me nr.47 (Kartela anëtarësimi) që kërkonti të prokuroni.

Për artikullin me nr.60 (Letër printeri termik), përveç këtij përshkrimi për këtë artikull nuk ka asnjë specifikim tjetër teknik që të mund të qartësojë produktin që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Printerat termike përdorin leter me rulon. Lutemi përcaktoni përmasat e sakta të rulonit.

Kërkuesat tona si më sipër janë në përputhje me:

Me nenin 36 të ligjit Nr.162/20202 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, në të cilin përcaktohet:

“...1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të

shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

“7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet europiane.”. Me pikën 38/b) të nenit 4 të LPP-së përcaktohet përkufizimi I specifikimeve teknike të mallrave e shërbimeve e konkretisht:

“?38. “Specifikime teknike” janë:

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë?”

Me pikën 2 të Nenit 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave) të VKM 285/2021, e ndryshuar përcaktohet:

“?2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara?”.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, pika 1, paragrafi 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar se, duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të

diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit, qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Legjislacioni I prokurimit publik, përcakton se, në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

hr@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani